

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti për të Mitur, në trupin gjykues për të mitur të përbërë nga gjyqtarja Kymete Kicaj, si kryetare e trupit gjykues, gjyqtarit profesionist Refki Piraj, gjyqtarëve porot Fetah Kelmendi, Fetije Kasemi dhe Ali Bush, anëtarë, me sekretaren juridike-procesmbajtësen Besnike Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarës: A. B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale – mundësim prostitucionit, nga neni 241 paragraf 4 të KP-së, dhe të akuzuarit M. B., nga Prizreni, për shkak të veprës penale – sulm seksual, nga neni 232 paragraf 1 të KP-së, të akuzuar sipas aktakuzës së ricilësuar të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.168/2014, të dt.08.09.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në seancë jo publike, në prezencën e të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, me datë 21.01.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I.

E akuzuara:

A. B., nga i ati R., e ëma Sh., e lindur G., data e lindjes... në Prizren, – shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

Se në periudhën kohore mars – qershor, rekruton ndihmon dhe kontrollon personin tjetër për qëllime të prostitucionit, në rastin konkret të dëmtuarën M. M. duke e shfrytëzuar afërsinë që kishte me të, ashtu që hap një adresë në rrjetin social Facebook, në emër të rrejtshëm dhe ate T. M., duke e paraqitur të dëmtuarën si femër e cila ofron marrëdhënie seksuale me pagesë, dhe duke e kontrolluar të njejtën me qëllime të prostitucionit e detyron të takohet me persona të caktuar sikurse një person i cili ka jetuar në botën e jashtme duke i'a mundësuar takimin me të dëmtuarën i cili më pas në një automjet ka kryer aktin seksual dhe pas kryerjes së aktit i ka dorëzuar të hollat të cilat e dëmtuara M. i'a ka dorëzuar të akuzuarës, si dhe ka aranzhuar takimet e të dëmtuarës M. me të akuzuarin e dytë M. B.

Me këtë ka kryer veprën penale – mundësim i prostitucionit, nga neni 241 paragraf 4 të KP-së.

Andaj gjykata duke vepruar konform neneve 41, 42 paragraf 1.1, 43 paragraf 1 nën paragraf 1.2 dhe 1.3, nenit 45,46, 73, 74 dhe 83 si dhe nenin 241 paragraf 4 të KP-së, lidhur me nenin 365 të KPP-së, i shqipton:

DËNIM ME BURGIM

Në kohëzgjatje prej1 (një) viti, në të cilin denim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 13.06.2014 deri me datën 10.01.2015. dhe

DENIMIN ME GJOBË në shumën prej 500 (pesëqindë) euro, të cilin denim e akuzuara detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse e akuzuara nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën gjykata do ta zëvendësoj denimin me gjobë me denim me burgim në atë mënyrë që për një ditë burgimi do t'i llogaritet me 20 (njëzetë) euro gjobë.

Obligohet e akuzuara që të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale, dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 (njëqindë) Euro, në afat prej 15 ditësh nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

E dëmtuara: M. M. nga Prizreni, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

II

I akuzuari M. B., nga i ati O., e ëma Sh., e lindur G., data e lindjes..., në Prizren, – shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 364 paragraf 1 nën paragraf 1.1 të KPP-së.

LIROHET NGA AKUZA

Në periudhën kohore Mars – Maj 2014, në Prizren, me qëllim seksual prek të dëmtuarën M. M. e moshës 17 vjeqare, në atë mënyrë që pasi paraprakisht kishte kontaktuar me të akuzuarën e parë A. B. përmes rrjetit social Facebook, ku edhe është aranzhuar takimi i të akuzuarit me të dëmtuarën M. në zyrën e tij, në ndërtesën e D. së F. në Prizren, ku në takimet në fjalë i njëjti e ka prekur me duar nëpër pjesët e trupit për qëllime seksuale pa pëlqimin e saj dhe se me këto raste për këto shërbime të dëmtuarës i ka dhënë para në shumat prej 10 deri në 20 euro, e të cilat para më pas e dëmtuara i'a ka dhënë të akuzuarës A. B.

Këso dore kishte për të kryer vepër penale – sulm seksual, nga neni 232 paragraf 1 të KP-së.

Sepse vepra penale për të cilën ngarkohet i akuzuari nuk përbën vepër penale.

Shpenzimet për këtë pjesë të procedurës u bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

1.Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Prizren ka parashtruar aktakuzë PP.nr.168/2014, të dt. 8.09.2014, kundër të akuzuarës: A. B. nga Prizreni, për shkak të dy veprave penale – trafikimi me njerëz, nga neni 171 paragraf 1 lidhur me paragrafin 2 të KP-së, dhe të akuzuarit M. B., nga Prizreni, për shkak të veprës penale – shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit, nga neni 231 paragraf 2 lidhur me paragrafin 1 të KP-së.

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti për të Mitur, duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 25.09.2014, kurse e akuzuara A. B. u deklarua e pafajshme, për veprën penale – trafikim me njerëz, nga neni 171 paragraf 1 lidhur me paragraf 2 të KP-së, edhe i akuzuari M. B. nuk pranoi fajësinë për veprën penale – shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit, nga neni 231 paragrafi 1 të KP-së.

Pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar para shqyrtimit të dytë mbrojtësit i të akuzuarve av.A. R. dhe av.B. T. kanë paraqitur kërkesë për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave konform nenit 249 dhe 250 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Pas shqyrtimit të kërkesave për hudhjen e aktakuzës të parashtruar nga mbrojtësit e të akuzuarve i është dhënë mundësia Prokurorit të Shtetit të përgjigjet me shkrim apo gojarisht.

Prokurori i Shtetit në seancën e shqyrtimit të dytë ka kërkuar që kërkesat për hudhjen e aktakuzës të refuzohet si të pabazuara dhe lidhur me këtë çështje të zhvillohet shqyrtimi gjyqësor. Gjykata duke vepruar konform dispozitave të KPP-së dhe rrjedhës së kësaj çështje pas ndërmarrjes së gjithave veprimeve ligjore ka kaluar në fazën e shqyrtimit gjyqësor.

2.Shqyrtimi gjyqësor dhe deklarimi i palëve

Në shqyrtimin gjyqësor **Prokurori i Shtetit Genc Nixha**, në fjalën përfundimtare ka bërë ricilësimin e aktakuzës duke cituar si në vijim.

I. Se e akuzuara A. B., gjatë periudhës kohore mars – qershor, rekruton ndihmon dhe kontrollon personin tjetër për qëllime të prostitucionit, në rastin konkret të dëmtuarën M. M. duke e shfrytëzuar afërsinë që kishte me të, ashtu që hap një adresë në rrjetin social Facebook, në emër të rrejshëm dhe ate T. M., duke e paraqitur të dëmtuarën si femër e cila ofron marrëdhënie seksuale me pagesë, dhe duke e kontrolluar të njëjtën me qëllime të prostitucionit e detyron të takohet me persona të caktuar sikurse një person i cili ka jetuar në botën e jashtme duke i'a mundësuar takimin me të dëmtuarën i cili më pas në një automjet ka kryer aktin seskual dhe pas kryerjes së aktit i ka dorëzuar të hollat të cilat e dëmtuara M. i'a ka dorëzuar të akuzuarës, si dhe ka aranzhuar takimet e të dëmtuarës M. me të akuzuarin e dytë M.B.

Këso dore ka kryer veprën penale – mundësim i prostitucionit, nga neni 241 paragraf 4 të KP-së.

II. Se i akuzuari M. B., në periudhën kohore Mars – Maj 2014, në Prizren, me qëllim seksual prek të dëmtuarën M. M. e moshës 17 vjeqare, në atë mënyrë që pasi paraparakisht kishte kontaktuar me të akuzuarën e parë A. B. përmes rrjetit social Facebook, ku edhe është aranzhuar takimi i të akuzuarit me të dëmtuarën M. në zyrën e tij, në ndërtesën e D. së F. në Prizren, ku në takimet në fjalë i njëjti e ka prekur me duar nëpër pjesët e trupit për qëllime seksuale pa pëlqimin e

saj dhe se me këto raste për këto shërbime të dëmtuarës i ka dhënë para në shumat prej 10 deri në 20 euro, e të cilat para më pas e dëmtuara i'a ka dhënë të akuzuarës A. B.

Këso dore ka kryer veprën penale – sulm seksual, nga neni 232 paragraf 1 i KP-së.

Prokurori i shtetit i është referuar provave që gjinden në shkresat e lëndës dhe atyre të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, ka cekur se në mes të të akuzuarës A. B. dhe të dëmtuarës M. M. ka pasur një shoqëri permanente në mes tyre, por sipas bindjes së Prokurorit është vërejtur se e akuzuara ka pasur ndikim tek e dëmtuara, pasi që ky lloj ndikimi ka qenë duke e ditur se e dëmtuara është e mitur dhe se e dëmtuara kishte besim tek e akuzuara, e kjo është vërtetuar nga deklarimi i të dëmtuarës M. M. e cila në mundësinë hetuese të veçantë të dt.26.06.2014, e cila në mënyrë të detajuar ka paraqitur veprimet e të akuzuarës A., e cila ka deklaruar se e akuzuara e ka kontrolluar të dëmtuarën si dhe përmes facebook-it apo në forma të tjera i'a ka aranzhuar takimet me perosnat të ndryshëm për të kryer shërbime seksuale me pagesë, e që më pastaj një pjesë të shpërblimit të marrur nga e dëmtuara e ka përfituar e akuzuara A. Prokurori ka propozuar që këtë pjesë të deklarimit të dëmtuarës t'i falet besimi sepse në tërësi përputhet edhe me deklarimin e dëshmitarit G.K., T. N., dhe P. E. e poashtu përputhet edhe me mbrojtjen e të akuzuarës A. B. Dëshmia e dëshmitarit P. E. vërteton faktin se e akuzuara A. i kishte propozuar dëshmitarit që të dilte me M. dhe për këtë i'a kishte kërkuar 30 euro. Për të vërtetuar në raportet në mes të akuzuarës dhe të dëmtuarës në këtë rast prokurori ka cekur se kjo është vërtetuar edhe nga foto-dokumentacioni në shkresat e lëndës e që janë shkarkuar nga telefoni i të akuzuarës ku vërehet se e dëmtuara gjithnjë ka qenë në shoqëri të të akuzuarës dhe çdo sjellje dhe veprim i të dëmtuarës ka qenë e kontrolluar nga e akuzuara. Ndërsa nga dëshmia e dëshmitarit G. K. është vërtetuar se takimi me të akuzuarin M. B. është aranzhuar nga e akuzuara A. e cila ka pritur në fast food "Aurora" përderisa G. dhe e dëmtuara realizonin takimin me të akuzuarin M. B.

Ndërsa sa u përket veprimeve inkriminuese të të akuzuarit të dytë M. B., prokurori i çështjes i është referuar provave – dëshmisë së të dëmtuarës M. M. e cila në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se pasi që e akuzuara A. kishte kontaktuar përmes facebook me të akuzuarin M. B. e kishin lënë të takoheshin në zyrën e tij e më pas i akuzuari ia kishte dhënë 100 euro, e një pjesë të këtyre të hollave i'a kishte dhënë të akuzuarës A. e pjesën tjetër kishte blerë gjësende të ndryshme por edhe veshmbatje, siaps deklarimit të saj ajo kishte shkuar disa herë në zyrën e të akuzuarit M. dhe çdo herë kishte përfituar nga 10 – 20 euro por edhe mbushje telefonike, poashtu nga deklarimi i të dëmtuarës është vërtetuar se i akuzuari çdo herë kur kjo kishte në zyrën e tij ai e kishte prekur të dëmtuarën në pjesë të ndryshme të trupit e duke përfshirë edhe pjesët intime të të dëmtuarës. Se kanë ekzistuar kontaktet në mes të akuzuarit dhe të dëmtuarës është vërtetuar edhe nga deklarimi i dëshmitarit G. K., përmes listingut të telefonatave.

Andaj nga të cekurat më lartë prokurori i çështjes ka propozuar që të akuzuarit të shpallen fajtor për veprat penale për të cilat ngarkohen dhe të denohen në bazë të ligjit.

E dëmtuara M. M., gjatë dhënies së dëshmisë së saj në seancën e mundësisë hetuese së veçantë ka deklaruar se me të akuzuarën A. B. ishte njohur nga vera e viti 2013 përmes një shoqes të quajtur D., ka cituar se fillimisht raportet ishin aq të mira sa që kam menduar se ajo më don si motër por ajo më ka konsideruar si prostitute, që do të thotë se ajo më ka detyruar që të shkoj me meshkuj të ndryshëm dhe t'ju marr para atyre. Ka theksuar në fillim të shoqerimit të tyre kanë vizituar familjet e njëra tjetrës dhe se kanë dalur bashkë në qytet, madje ka shtuar se A. së bashku me nënën e saj kishin ardhur në familjen e M. për ta lutur nënën e M. që ta lejonte M. të shkonte në

shtëpinë e tyre kur A. e kishte ditëlindjen dhe nëna e M. e kishte lejuar atë që të shkonte te e akuzuara, kështu që M. kishte krijuar besim tek A. dhe kishte kaluar natën te ajo dhe e kishin festuar ditëlindjen, por edhe A. kishte marrë pjesë në ditëlindjen e 17-të të M., kështu që A. ishte në dijeni për moshën e M. Më tej e dëmtuara përshkruan ngjarjen se si një ditë së bashku me A. deri sa po pinin kafe në qytet, A. i kishte treguar se kishte hapur një adrese në facebook me emrin T. M., atëherë M. e kishte pyetur se çfarë do të bënte me atë adresë ndërsa A. i kishte thënë: kam nevojë për para, kështu që ti a pranon të del me meshkuj dhe t'iu kërkosh para, M. tregon se nga frika që kam pasur nga A. kam pranuar të dal me ata persona, duke mos e ditur fare se çka ka fol A. me ata persona apo çfarë i'u ka premtuar. Me tutje ka shtuar se ka pasur rast që A. më ka mbrojtur nga sulmet e disa vajzave që kan dashur të më rrahin andaj kam mednuar se ajo është në gjendje edhe mua të më bëjë ndonjë të keqe. M. përshkruan herën e parë që A. e kishte aranzhuar një takim me një mashkull që unë nuk e njihja më parë ka qenë pikëtakimi në QT. "Abi", ka deklaruar se atje shkuam së bashku me G. i cili duhej të prezentohej si vëllau im, ndërsa A. dhe vëllau i saj A. shkuan në park që të na prisnin, A. i kishte thënë se personi në fjalë do të priste përpara fontanës dhe ia kishte dhënë M. telefonin e saj, poashtu i kishte thënë se atij duhej ti prezentohej si T. M., nga Prizreni se është 19 vjeç dhe nuk punon askund, dhe nuk vazhdon shkollimin dhe posa të takohej me të ta pyeste atë se a e ke kry atë punën dhe a do të më jep para. Kështu që para se të takohej me atë djalë, ai i kishte telefonuar në telefonin qe ia kishte dhënë A. të saj, dhe ishin takuar në reastaurantin e Abit, M. së bashku me G. ndërsa ai personi ishte me një djalë tjetër, sipas bisedës së zhvilluar ai personi kishte pritur se M. do ti dilte së bashku me një shoqe tjetër sepse A. ashtu i kishte premtuar dhe e kishte pyetur se ku e ke shoqen, M. tregon se nuk e kishte pyetur atë djalë fare se si quhej se ishte friguar se do të dyshonte se nuk jam unë ajo që jam prezentuar në Facebook, pas disa minutave M. i kishte cingruar telefoni dhe këtë e përdor si pretekst për të ikur nga aty, duke u arsyetuar se po me kërkon mami dhe ishte ngritur për të dal por ai djal nuk i kishte dhënë para vetëm se i kishte thënë merre shoqen dhe dalim përsëri në mbërmje shkojm dikah tjetër, këtë ia tregova A., dhe vërtetë ashtu ndodhi ai djalë thirri në telefonin e A. dhe unë fola me të duke e lënë të takohemi në vendin e njëjtë te Abi, unë i tregova atij se shoqja nuk do të vjen, kështu që unë shkova me G. e ai përsëri ishte me shokun e tij, u takuam në Q.T. "Abi" ndërsa ai ishte me veturën a mori ne veturen e tij, përpara ishte ulur shoku i tij ndërsa mbrapa ishim unë dhe G., kur arritëm te piceria "Roma", ai djalë ia dha disa të holla G. dhe shokut të tij dhe ata zbritën nga vetura e tij, mbetëm vetëm unë dhe ai në veturë, ai më tha mua a din ndonjë vend ku mund të shkojmë, unë i thashë jo, kështu që ai u nis në drejtim të parkut të qytetit e parkoi veturën doli mbrapa ku isha unë i mbylli dyert me qelës dhe filloi të më zhvishte, në fillim e kundërshtova por ai më tha nëse i don ato para që ke kërkuar në facebook duhet të kesh mardhënie seksuale me mua, atëhere e kuptova se kështu ka premtuar A. fillova të qaj edhe me shumë, ndërsa ai kryente aktin seksual me mua, pastaj më dha një kartëmonedhë që nuk më kujtohet vlera por e di qe u kthyem e morëm G. aty ku e kishim lënë dhe ato para ia dhashë A. sepse ajo mi ka kërkuar, unë atë natë nuk kam shkuar në shtëpinë time, kam fjetur në shtëpinë e A. rrëfimin e saj vazhdon duke thënë se kam vazhduar të shoqërohem me A. duke menduar se një gjë e tillë nuk do të ndodhë më, por pasi që kanë kaluar një javë ajo përsëri doli me një propozim tjetër kësaj here me tha se ti do të shkosh te posta kryesore të pret një burrë aty dhe ai ty do ti jep disa para por nuk do të bëj asgj, ajo m dha telefonin e saj dhe s bashku me mua ishte edhe G. Para se të arrinim te posta më telefonoi ai personi në telefonin e A. dhe më tha më pritni te posta unë do të dal aty, pas pak kohe aty erdhi një burrë në moshë dikë rreth 50-60 vjeç, i cili u prezentua por që nuk më kujtohet emri i tij ai me dha disa para nuk e mbaj mend 50 apo 100 euro dhe si i morëm paratë shkuam tek Aurora se aty na priste A. dhe ia dorëzova asaj paratë, më pas kemi dalur në qytet kemi pirë kafe, ndërsa pagesat i kryente A. Pas tri dite A. përsëri më ke thënë se duhet takohem me personin e njëjtë në vendin e njëjtë dhe përsëri ai nuk do të bëj asgjë, edhe kësaj here pranova që të shkoj së

bashku me G. ndërsa A. na priste pak më tutje, ai përsëri erdhi aty afër postës por nuk na dha asnjë para, na tha se duhej të hynim mbrenda n objektin ku ai punonte e që ishte përballë postës, posa hynëm mbrenda ai njeri ia dha G. disa të holla i tha të shkonte të blinte ndonjë gjë për të ngrënë, ndërsa mua ma mbylli derën dhe filloi të më prekë nëpër pjesë të ndryshme të trupit, ku unë e refuzoja dhe i thoja të më hapte derën por ai vazhdonte të më prekte, dikur nxori 10 euro mi dha edhe dy mbyshje telefonike me nga pesë euro të “valës” dhe “ipko-s”, pasi që i mora këto kam dalur nga zyra e tij poshtë objektit kishte qenë G. duke më pritur ndërsa përballë “Aurorës” na priste A., të cilës menjëherë ia kam dorëzuar paratë dhe mbushjet telefonike, ajo nuk më pyeti asgjë sepse e dinte se këto gjëra do të mi jepte ai personi. Pa kaluar as dy ditë të tjera A. përsëri më tha se duhet të shkosh te ai personi dhe kësaj here nuk do të bëj asgjë, unë duke pasur frikë kam shkuar te ai, përsëri unë isha me G., kur hyrëm në atë objekt ku ishte zyra e atij personi, pashë se në korridor kishte njerëz, mirëpo në zyrën e tij ishte vetëm ai, posa u ulëm në zyre ai personi na luti që të pinim diqka, unë nuk deshta asgjë ndërsa G. porositi diqka, pas kësaj ai personi i bëri me shenjë G. që të dilte jashtë e unë i thashë G. mos shko, por ai doli, ne mbetëm vetëm, ai e mbylli derën me qelës, unë e kundërshtova prekjet e tij, e ai më tha "se më ke premtuar në facebook se do të bësh qfarëdo që të kërkoj unë" dhe përsëri ka vazhduar të më prekë nëpër trup, pastaj mi dha 20 euro dhe ma hapi derën dhe dola, shkova te A. që me priste në vendin e njejtë dhe ia dhashë ato para. Këto vizita te ky personi i kam filluar në muajin maj dhe kanë vazhduar shumë herë, çdo secila vizitë ishte e njëjtë ai më prekte dhe në fund mi jepte disa të holla e ndonjëherë edhe ndonjë mbushje telefonike dhe të gjitha ia dorëzoja A., deri sa një ditë i thashë se nuk do të shkoj më te ai person por A. mu kërcënua duke më thënë se e sheh ti çka të gjen kur të kthehem prej Maqedonisë.

Ka përshkruar edhe raste të tjera kur ka dalur me meshkuj të ndryshëm, për tu takuar me ta dhe tu kërkonte para, të gjitha këto paraprakisht i aranzhonte A. përmes facebookit, deri sa një ditë hasen nga ana e policisë në një klub nate, dhe në momentin kur zyrtarja policore e vërenë se M. është e mitur, kërkon nga ajo që të paraqitet në stacionin policor, me ç’rast e dëmtuara rrëfen në tërësi ngjarjet e përjetuara gjatë kohës së shoqërimit të saj me të akuzuarën A.

Ndërsa e ftuar përsëri në shqyrtimin gjyqësor që të deklarohet vetëm sa u përket rrethanave që kanë të bëjnë me të akuzuarin M. B., e demtuara ka konfirmuar tërë ato që ka thënë në seancën e mundësisë hetuese së veçantë në raport me të akuzuarin M. B., duke cekur se të njëjtin e njeh përmes A. B., që disa herë apo siq ka cekur e dëmtuara dhjetra herë ka qenë në zyrën e tij, së bashku me G., çdo herë ai i ka dhënë para G. që të del jashtë zyres, ndërsa ai ka ngelur vetëm me të dëmtuarën mbrenda, çdo herë kur kanë ngelur vetëm i akuzuari e kishte mbyllur derën dhe e kishte prekur të dëmtuarën nëpër trup edhe në pjesët intime të trupit, e më pas çdo herë i kishte dhënë para, në vlera prej 10, 20 euro, përveç herës së parë që ia kishte dhënë 100 euro, të cilat para çdo herë ia kishte dorëzuar A. Të gjitha takimet me të akuzuarin M. B. ia kishte aranzhuar A. edhe G. Sipas deklaramentit të dëmtuarës i akuzuari nuk e kishte ditur moshën e saj të saktë, e as emrin e saj të vërtetë, por as nuk e kishte ditur se ato para për kënd po i merr, apo përse po i merr. Vlen të ceket se e dëmtuara është deklaruar se nuk ka përfituar asgjë nga ofrimi i këtyre shërbimeve, se të gjitha ia dorëzonte A.

Mbrojtësi i të dëmtuarës M.M., **av. H.K.**, ka deklaruar se në emër të të dëmtuarës parashtrom kërkesë pasurore juridike për shumën e së cilës do të përcaktohen në procedurë civile, pas plotësimit të kushteve ligjore për inicimin e kesaj procedure, njëherit ka shtuar se e mbështete në tërësi fjalën përfundimtare të paraqitur nga Prokurori i Shtetit.

E akuzuara A. B., gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor e ka mohuar kryerjen e veprës penale, ka cekur se me të dëmtuarën M. M. është njohur në fundverën e vitit 2013 përmes shoqeve D. dhe D. N., më pastaj kishin filluar shoqërimin mes tyre, sipas saj ka pasur raste kur janë dalur së bashku në qytet gjegjësisht nëpër kafiteritë e qytetit ku shpesh herë me to kishte qëndruar edhe vëllai i saj A., por edhe ka rastisur që M. ndonjëherë kishte kaluar natën në shtëpinë e saj. Për moshën e të dëmtuarës ka cekur se në fillim ka menduar se ajo është 19 vjeçare por menjëherë e kishte parë rastësisht qertifikaten e saj dhe e kishte kuptuar se ajo është nën 18 vjet. Në fillim të shoqërimit të tyre M. kishte poseduar telefon celular por që më pastaj i kishte humbur telefoni gjatë një ndeje në një ditëlindje, e më pas çdo herë kur i është dashur telefoni M. ishte shërbyer çdo herë me telefonin e saj, për këto shërbime telefonike nuk i kishte paguar asnjëherë asgjë. E akuzuara ka cituar se në fillim M. ka pasur një adresë në facebook me emrin e saj M. M. por më vonë e kishte mbyllur atë adresë dhe komunikonte përmes një adrese tjetër N. M., nga të dy adresat e saj kishte komunikuar me të akuzuarën, ndërsa kategorikisht ka mohuar ta ket hapur adresën T. M., thotë se kam pasur dyshime se këtë adresë e ka hapur G. K. Ajo e përshkruan të dëmtuarën si një vajzë që u fliste meshkujve të ndryshëm e për këtë e akuzuara ia kishte tërhequr vërejtjen, madje i kishte thënë të dëmtuarës "se mos më bjerë meshkuj në tavolinë". E akuzuara ka shtuar se shpesh herë e kishte mbrojtur M. nga sulmet e disa vajzave dhe në raste tjera. E akuzuara ka treguar raportet në mes saj dhe të dëmtuarës kane qene të një lloji të veçantë duke cekur se një herë i kishte treguar M. se kishte pasur marrëdhënie seksuale me një person dhe pikërisht për këtë e akuzuara ishte hidhëruar me të dëmtuarën dhe nuk i kishte folur, por M. ia kishte bërë deri në 70 telefonata vllait të të akuzuarës duke e lutur atë që ta pajtoj me A., e që në fakt edhe A. ia kishte falur dhe kishin vazhduar përsëri shoqërimin në mes tyre. Ka mohuar faktin që ti ket ofruar ndonjë mashkull M. për shërbime seksuale me pagesë, apo të ketë përfituar materialisht nga M., përveç se ka cekur se ndonjëherë M. ka qerasur por shton se edhe unë e kam qerasur shumë herë M.. E akuzuara në tutje shton se njëherë një person mashkull në telefonin e saj e kishte kërkuar T., me ç'rast e akuzuara e nervozuar nga kjo telefonatë e duke mos e ditur se kush është T. e kishte sharë personin që kërkonte T. dhe ia kishte mbyllur telefonin, nuk e mohon faktin se ka qenë në dijeni se M. atë kohë kishte një të dashur, por që është shoqëruar edhe me persona të tjerë, ndërsa nuk i kujtohej nëse M. a është takuar atë kohë me ndonjë person mashkull që ka ardhur nga Gjermania. Ndersa raportet me G.K. i përshkruan si shumë të mira të njëjtin deklaroi se e ka djalë të tezës, edhe ai është shoqëruar shumë me M., ndërsa në fund deklaroi se nuk ka qenë në dijeni se M. po ushtron prostitucion në atë kohë, e di që M. ka pasur para por ajo i kishte thënë se paratë po ia jepte nëna e saj dhe një fqinjë i saj që jetonte jashtë vendit .

I akuzuari M. B., nuk është deklaruar për çështjen penale për të cilën ngarkohet sipas aktakuzës së lartëcekur, i njëjti është mbrojtur në heshtje.

3.Provat materiale dhe dëshmitë e paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor,

Gjatë shqyrtimit gjyqësor pasi që të akuzuarit A. B. dhe M. B. nuk kanë pranuar fajësinë, Gjykata ka bërë administrimin e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht në mes tyre, vërtetoi gjendjen faktike ashtu siq është paraqitur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen faktike gjykata e ka vërtetuar përmes provave dhe dëshmive të prezentuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë nga:

Leximi i procesverbaleve të seancës së mundësisë hetuese të veçantë të dt. 26.06.2014 dhe 08.07.2014 ku është dëgjuar e dëmtuara M. M..

Deklarimi i të dëmtuarës – dëshmitarës M. M. në shqyrtimin gjyqësor,

- Shiqimi në qertifikatën e lindjes së të dëmtuarës M. M., lëshuar në Prizren, me dt., nr. rendor..., vërtetohet se e njëjta është e lindur me datë të lindjes...
- Leximi i raportit psikiatrik për të dëmtuarën M. M., përpiluar nga eksperti gjyqësor psikiatri për fëmijë dhe adoleshent dr. N.F..
- Nga deklarimi i ekspertit Dr. N.F., dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt.11.08.2015.
- nga dëshmia e dëshmitarës F. M. dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt.28.05.2015.
- Nga dëshmia e dëshmitarit G. K. dhënë në seancën e dt.09.02.2015.
- Nga dëshmia e dëshmitarit M. K. dhënë në seancën e dt.09.02.2015.
- Leximi i raportit të ekspertizës nga Agjensioni i Kosovës për Forenzikë, AKF-2014-0056, të dt.27.06.2014
- Leximi i telekomunikimeve – mesazheve telefonike, të dhëna nga PTK, Zyra për veprim sipas kërkesave ligjore, nga Operatori "Vala" të dt.25.06.2014 dhe të dt.26.06.2014 ZKLM.1926/14, për numrin e telefonit ..., në posedim të të cilit numër ka qenë e akuzuara A. B.
- Leximi i raportit ligjor nga PTK – operatori "Vala" me listingun e thirrjeve të numrit... në posedim të të cilit ka qenë i akuzuari M. B.
- Shiqimi në listingun e thirrjeve telefonike nga Operatori "Ipko" të numrave... në posedim të të cilit ka qenë e akuzuara A. B. dhe numrit... në posedim të të cilit ka qenë dëshmitari T. N.,
- Shiqimi në fotodokumentacionin – fotoalbumi të shkarkuara nga telefoni markës samsung, me dt.08.07.2014, i cili i përkiste të akuzuarës A. B..
- Shiqimin në listingun e thirrjeve nga Operatori Z Mobile dhe numrit... në posedim të këtij numri ka qenë M. K.
- Nga dëshmia e dëshmitarit P. E., dhënë në procesverbalin e dt. 11.08.2015.
- Nga dëshmia e dëshmitarit T.N. dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.11.08.2015
- Nga dëshmia e dëshmitarit D. G., dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt.28.10.2015.

4. Vlerësimi i dëshmive të dëshmitarve dhe provave materiale të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor,

Nga dëshmia e të dëmtuarës M. M. është vërtetuar se e njëjta ishte shoqëruar intenzivisht me të akuzuarën A. B., në fillim të shoqërimit të tyre e dëmtuara kishte pasur telefon celular e më pas i kishte humbur, dhe në vazhdimësi është shërbyer me telefonin e të akuzuarës A. B., e për këto shërbime asnjëherë nuk e kishte paguar. Se e akuzuara kishte një raport të veçantë me të dëmtuarën M. M., kjo është vërtetuar, nga pjesa e deklarimit të të dëmtuarës, kur ka cekur se e akuzuara e kishte mbrojtur shumë herë por e kishte mbrojtur edhe nga sulmet e disa vajzave që xhelozonin për faktin se e dëmtuara shoqërohej me të akuzuarën, poashtu është vërtetuar se e akuzuara kishte një lloj kontrole të vazhdueshme ndaj të dëmtuarës, kjo kontrollë e të akuzuarës arrihej përmes djalit të tezes së saj G., i cili të dëmtuarën e kishte përcjellur në çdo dalje apo takim të saj, që e akuzuara ia aranzhonte me meshkuj të ndryshëm për të përfutur para. Po ashtu nga dëshmia e të dëmtuarës

është vërtetuar se e dëmtuara ndjente një lloj frikë nga e akuzara A., në rastin kur i kishte thënë se ajo nuk do të del më me të akuzuarin M. B., e akuzuara i kishte thënë se "e sheh ti çka të gjen sa të kthehem prej Maqedonisë". Mund të konkludohet se shoqërimi i të dëmtuarës me të akuzuarën nuk ishte i rastësishëm, kur kihet parasysh se ato nuk i bashkonte as mosha, as fqinjësia, e as shkolla, se e akuzuara kishte qëllim të caktuar të shoqërimit të saj me të dëmtuarën, pasi që ka vërejtur se e dëmtuara është vajzë e hedhur, për shkak të moshës së ndjeshme, por edhe për shkak të të kaluarës së saj dhe shoqërimit me meshkuj që në moshë të re, kjo situatë e të dëmtuarës ka qenë favorizuese për të akuzuarën për ta përdorur naivitetin e të dëmtuarës si një lloj karremi që nëpërmes rrjetit social facebook nga adresa T. M. te cilën e përdorte e akuzuara, e paraqiste te dëmtuarën si një vajzë që ofronte shërbime seksuale me pagesë.

- Dëshmia e të dëmtuarës është e besueshme, pothuajse në tërësinë e saj, ngjarjet i përshkruan hollësisht në mënyrë të kurtë, në deklarinë e saj nuk ka ndonjë zbrastësi që do ta relativizonte dëshminë e saj. Deklarimi i saj pjesërisht përputhet edhe me mbrojtjen e dhënë nga e akuzuara A. B., pjesërisht me deklarinë e të akuzuarit M. B. dhënë në Prokurorinë Themelore në Prizren dhe me dëshminë e dëshmitarit G. K..

- Rrëfimi i të dëmtuarës posaqërisht ka qenë i rëndësishëm përkitazi me rrethanën e vërtetimit të veprës penale – mundësim i prostitucionit gjegjësisht elementet kryesore që e përbëjnë këtë veprë penale e që janë:

- Rekrutimi, organizimi, ndihma ose kontrollimi personin tjetër për qëllime të prostitucionit.

- Dëshmia e saj nxjerrë në pah veprimet e të akuzuarës në raport me këto elemente të veprës penale: organizimin që ka kuptim mjaftë të gjerë e që ju referohet disa rrethanave siq janë: gjetja e klienteve për të shfrytëzuar shërbimet seksuale, përmes reklamave të ndryshme për prostitucion apo organizimi i mënyrës së pagesës etj, ndërsa ndihmën si element i kësaj veprë penale në ushtrimin e prostitucionit si shprehje në këtë kontekst ka disa forma dhe këtu mund të përfshihen

Nga deklarimi i dëshmitares F. M. është vërtetuar se për një kohë vajza e saj M. është shoqëruar me të akuzuarën A., madje disa herë e kishte lejuar M. që të kalonte natën te A., te e njëjta kishte besim, ka deklaruar se e akuzuara dhe M. pothuajse qdo ditë kanë dalur në qytet, shpeshë herë vinte A. vet e thriste M. por ka pasur rast që A. e ka dërguar edhe G. që ta thret M. për të dalur. Fillimisht kur kanë filluar të dalin janë kthyer më herët e ka pasur rast edhe që janë vonuar deri në orët e vonshme pas mesnate, për këtë ia kishte tërhequr vërejtjen të mos del me A. për shkak të këtyre daljeve të shpeshta dhe të vonshme, për daljet në qytet M. i kishte dhënë nga 50 cent deri në një euro, por jo më shumë, se në atë periudhë M. nuk ka veshur ndonjë rrobe të dyshimt që të mos të dihet se kush ia bleu. Ndërsa ka deklaruar se kurrë nuk ka dëgjuar për M. B. dhe nuk e ka porositur M. për t'ia nxjerrë ndonjë dokument nga administrata komunale në Prizren.

- Dëshmia e kësaj dëshmitare ka qenë e rëndësishme për faktin për të sqaruar raportet në mes të dëmtuarës dhe të akuzuarës A., nga kjo dëshmi është vërtetuar se për një kohë relativisht të gjatë (disa muajshe) ato kanë qenë në shoqëri të vazhdueshme me njëra tjetrën dhe se kanë dalur çdo ditë në qytet duke qëndruar deri në orët e vona, po ashtu është vërtetuar se M. nuk kishte pasur para në atë kohë. Duke analizuar pjesën e dëshmisë e dëshmitares së M. ia ipte vetëm nga 50 cent apo një euro, atëherë si të shpjegohet ndryshe fakti se si i siguronte paratë M. për të mbuluar shpenzimet ditore të daljeve të gjata të çdo ditëshme.

Nga dëshmia e dëshmitarit G. K. është vërtetuar se është shoqëruar me M. M. në atë kohë kur edhe A. është shoqëruar me të, edhe pse thotë se M. e kishte njohur nga shkolla, pasi që ajo kishte qenë në klasën e nëntë ndërsa G. në klasën e shtatë, ka deklaruar se një kohë kanë dalur në vazhdimësi së bashku nëpër kafiteritë e shpesh herë me ta ka qenë edhe A., ka treguar se A. e ka vajzë të tezes, sa i përket adresës së T. M. thotë se ai nuk kishte pasur qasje në atë adresë, ndonëse në prokurori kishte pranuar se atë adresë e kishte hapur A., dhe se takimin me M. B. ia kishte planifikuar A., ndërsa në shqyrtimin gjyqësor e mohon këtë fakt. Dëshmitari ka vazhduar me dhënien e dëshmisë së tij duke potencuar faktin se në zyren e M. B. kishin qenë 2-3 herë së bashku me M., se M. atij i kërkonte para, njëherë i kishte kërkuar 100 euro nga M. B., duke u arsyetuar se e ka nënën me kancer, e ai ia kishte dhënë asaj 100 euro, e herave tjera gjente asrye të ndryshme ti kërkonte para M. B., madje njëherë M. e kishte dërguar këtë që në emër të M. ti kërkonte para M. B. duke e gënjyer se M. e kishte therur një vajzë e po i duhen para për shkak se gjendet në arrest shtëpiak, me ç'rast sipas tij M. ia kishte dhënë 50 euro. Ka mohuar ta ketë parë M. duke e ngacmuar seksualisht M., pastaj ka treguar se M. në atë kohë kishte shumë para, por nuk e di se kah i ka siguruar ato para, më tej ka shtuar se disa herë M. i kishte thënë të priste në ndonjë vend të caktuar përderisa ajo shkonte me ndonjë mashkull në vende tjera, kur vinte ajo ia tregonte paratë dhe çdo herë i kishte thënë se mos i trego A. për këto para, por nuk ka sqaruar se përse të mos i tregonte A. për paratë që kishte M., ka pranuar se një herë M. ia paska blerë këtij një palë patika dhe që ndonjëherë i kishte dhënë nga dy-tri euro.

- Dëshmia e këtij dëshmitari ishte e paqëndrueshme ai binte në kundërshtim me vet deklarimin e tij dhënë në Prokurori, thotë të ketë deklaruar para Prokurorit të çështjes në këtë mënyrë nga frika që ka pasur nga policja me emrin M. edhe pse ajo nuk kishte qenë prezent gjatë dhënies së deklaratës së tij në Prokurori, ndërsa është deklaruar se ndihet njësoj edhe gjatë dhënies së dëshmisë në Gjykatë, edhe pse dëshmisë së tij po ipte kahje tjetër, i cili haptazi po fshehte faktet e rëndësishme të cilat padyshim se e dinte që ato që po deklaronte janë të pavërteta, por i njëjti vazhdimisht eskivonte përgjigjet e tij e që është e kuptueshme se këtë e bënte për shkak të solidarizimit me tezaken e tij – të akuzuarën A.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit P. E. është vërtetuar se me të akuzuarën A. dhe me M. M. ishin njohur fare rastësisht në një kafiteri të qytetit të quajtur Checkin, atë ditë M. dhe A. po qëndronin në atë kafiteri së bashku edhe me dy shoqe të tjera, njëra nga ato shoqet ishte ngritur nga tavolina ku ishte ulur dhe i ishte afruar te tavolina ku po qëndronte dëshmitari dhe nga ai ka kërkuar telefonin e më pas kishte krijuar njohje edhe me vajzat tjera që po qëndronin në atë tavolinë, i kujtohej mirë, se pas qëndrimit disa minutash në atë kafiteri, ishin ngritur nga aty dhe njëra prej vajzave kishte propozuar që të shkonin diku më larg qytetit për të ngrënë drekë, edhe ashtu kishte ndodhur, dëshmitari me veturën e tij i kishte marrë që të katër vajzat dhe kishin shkuar në fshatin Reqan në restaurantin "Te Fuadi" aty kishin ngrënë drekë, pasi që kishin përfunduar drekën dëshmitari i kishte shpërndarë të gjitha vajzat dhe kishte ngelur në veturë vetëm me A., për të cilën kishte menduar se është i gjinisë mashkullore sepse nga pamja dukej si djalë. Përderisa ishin vetëm i kishte thënë A. dëshmitarit "se a don ta qes M. në kerr, ti mi jep 30 euro për këtë" (M. ishte shkrutesa për M.), dëshmitari më tej tregon se nuk kishte pranuar të del me M. edhe pse ajo nuk i ishte dukur si e mitur. Dëshmitari ka treguar se me A. komunikonte përmes telefonit e ka pasur rast të komunikoj me telefon të A. edhe me M., por me M. kishte biseduar edhe përmes facebook-it nga adresa e vllait të saj, në një komunikim që kishte pasur me M. ajo ia kishte kërkuar një palë farmerka por ky nuk ia kishte blerë, më pastaj ishin takuar dhe dy apo tri herë tjera me këto vajza e njëherë e kishte thirrë A. që ti ofronte ndihmë M. për shkak se atë po e sulmonin disa vajza, ka treguar se ka shkuar në lagjen e saj dhe e ka marrë me veturën e tij.

- Dëshminë e këtij dëshmitari, gjykata e çmoi si të besueshme, dëshmia e tij bënë të qartë faktin se e akuzuara dhe M. sa lehtë krijonin shoqëri me meshkuj që nuk njiheshin më parë, që kjo mënyrë e shoqërimit të tyre kishte qëllime të caktuara për të akuzuarën A., vetëm atë të përfitimit të parave, kjo vërtetohet nga pjesa e deklarimit të këtij dëshmitari që tregoi se e akuzuara A. ia kishte ofruar atij M. e që nga ai për këtë shërbim ia kishte kërkuar 30 euro.

Nga dëshmia e dhënë e dëshmitarit T. N., deklaroi se numrin e tij të telefonit i ishte lajmruar një zë femre, nuk i kujtohej mirë se a quhej N. apo T., kjo vajzë nga ai kërkonte që të vinte në Prizren dhe t'ia sillte 20 euro se po i duheshin, për këtë asrye ai nuk kishte ardhur nga se kishte krijuar bindje se kjo vajzë nuk është vajzë e mirë se kjo ofronte seks me para, andaj nuk kishte pasur ndonjë interesim për të njejtën, ka theksuar se ka shkëmbyer pak sms, dhe nuk ka komunikuar gjatë me të njejtën.

- Dëshmia e këtij dëshmitari nuk ka zbardhur ndonjë rrethanë konkrete lidhur me rastin.

Dëshmitari D. G. ka treguar se A. e ka vajzë të hallës, ndërsa edhe G.K. e ka djalë të hallës, ndërsa kurrë nuk e kishte njohur e as nuk kishte dëgjuar për M. M., po ashtu ka treguar se në periudhën kohore të viti 2014 ka pasur një adresë në facebook me emër të djalit të vllait "B.B." se nga ajo adresë ka komunikuar me T. M., nuk i është kujtuar se kur ka komunikuar me të e as sa ka zgjatur komunikimi mes tyre por ka theksuar se ajo femër e kishte provokuar, nuk e dinte saktësisht se çfarë natyre ka qenë provokimi por sipas tij ajo "T. M." ia kishte përmendur disa rrethana familjare, me ç'rast ky ishte nervozuar me të dhe e kishte sharë rëndë atë, më tej ka shtuar se edhe gjatë kohës sa ka qenë A. në paraburgim ajo përsëri e kishte kontaktuar përmes facebook-it e tani me nofkën T. L., krejt në fund ka shtuar se ka dyshuar se mbrapa nofkës T. M. mshefet G. K.

- Dëshmitari ishte mjaftë konfuz gjatë dhënies së dëshmisë së tij, por nga konteksti mund të nxjerret konkludim se i njejtë paraprakisht nuk e ka njohur M. e as M. nuk e ka njohur D., andaj ftesa për shoqërim në facebook nga adresa T. M. nuk i ka ardhur nga M.

Ndërsa dëshmitari M. K., ka deklaruar se është e vërtetë se ai ka shumë numra telefoni të regjistruar në emrin e tij, po thujse kishte marrë numra të telefonit për krejt antarët e familjes, madje disa numra telefoni që figurojnë në emër të tij mund të jenë tjetërsuar personave jashtë familjes së tij. Nuk ka pranuar faktin të ketë dërguar sms në numrat e telefonit të akuzuarës A. apo të dëmtuarës M., e as nuk kishte dëgjuar për këto më parë.

Dëshmia e dëshmitarit M. K. ishte jorelavanete për çështjen andaj si të tillë nuk është parë e arsyeshme shtjellimi i mëtutjeshëm i dëshmisë së tij.

Nga raporti i ekspertizës psikiatrike për të dëmtuarën M. M. e përpiluar nga eksperti gjyqësor Dr. N. F., është vërtetuar se tek e dëmtuara nuk është konstatuar ndonjë çrregullim psikiatrik, se pjekuria emocionale dhe intelektuale janë përshtatshëm me moshën kalendarike të saj, te e njëjta është ruajtur aftësia për të dëshmuar dhe nuk ka deficite psikologjike, ndaj saj duhet të vazhdoj përkrahja psikosociale me qëllim të mbështetjes substanciale, për të ndërtuar forcat e nevojshme ballafaquese për riintegrimin social si dhe ndërtimin e kapaciteteve parandaluese.

Ndërsa në shqyrtimin gjyqësor të dt.11.08.2015, eksperti gjyqësor Dr. N. F. ka dhënë sqarime rreth situatës së të dëmtuarës e cila në fëmijëri në moshën 8 vjeçare kishte pasur humbje të vetëdijes për shkak të temperaturës së lartë dhe e cila është trajtuar me medikamente për rreth një viti, duke cituar se kjo gjendje e të dëmtuarës në fëmijëri nuk ka lënë e pasoja në zhvillimin e saj kognitiv apo intelektual, ashtu siq janë cekur edhe në raportin me shkrim se te e njëjta nuk janë vërejtur probleme me kujtesën.

Gjykata i fali besimin e plotë kësaj ekspertize, për faktin se njëjta është kryer nga profesionisti i lëmisë përkatëse, pas ekzaminimit direkt të të dëmtuarës, së konstatimet e kësaj ekspertize janë të mbështetura në të arriturat shkencore dhe profesionale.

Nga qertifikata e lindjes për të dëmtuarën M. M., lëshuar në Prizren me dt.07.06.2012, me nr. rendor..., vërtetohet se e njëjta është e lindur me dt...

Nga raporti i ekspertizës nga laboratori për ekzaminimin e kompjuterive përpiluar nga Agjensioni i Kosovës për Forenzikë AKF-2014-0056, të dt.27.06.2014 është vërtetuar se është ekzaminuar telefoni i tipit Samsung modeli GT-C33222 ka rezultuar me gjetjen e disa fotografive dhe videofajlave, kurse janë ekzaminuar edhe dy SIM kartela te operatit Vala me numër serik... dhe Operatorit Ipko me numër serik..., janë gjetur të dhënat si kontaktet, thirrjet dhe mesazhet.

Nga shiqimi në fotodokumentacionin që është shkarkuar nga telefoni i të akuzuarës, shihen një mori e fotove. Në shumë foto vërehet se e dëmtuara M. është në vazhdimësi në krah të akuzuarës A. e që nga këto foto pasqyronin faktin se e akuzuara kishte edhe një miqësi tjetër të karakterit të ngushtë shoqëror por edhe foto të tjera me përmbajtje dhe karaktere të ndyshme, pastaj disa foto të grumbujve me para etj.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe të gjithëanshëm të gjendjes faktike është e nevojshme komunikimet përmes sms-ve që janë bërë nga telefoni i të akuzuarës A. B. në mes T. M. dhe të akuzuarit M. B. dhe njëkohësisht me persona tjerë të cilët komunikonin me T. M., i cili përgjim është bërë me masa të fshehta të hetimit, të bazuara në urdhëresë e lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake.

Nga informacioni i lëshuar nga zyra për kërkesa ligjore pranë PTK vërtetohet se e akuzuara A. B. ka qenë në posedim të numrit të telefonit..., ndërsa i akuzuari M. B. ka qenë në posedim të numrit...

Në një komunikim përmes sms-ve të dërguara nga numri i të akuzuarit M. B. (...), në numrin e të akuzurës A.B. (...) gjegjësisht komunikimi i dedikohet "T.", tekstualisht shkruan si vijon:

- Me dt. 21.03.2014, "Pse nuk pe qel teli" ndërsa me dt.22.03,2014 ora 13:25, i akuzuari përsëri nga numri i lartëcekur shkruan "tash jam në zyre, kur po vjen?" mesazhi tjetër pason "a po vjen ti japi 20 euro", "hajde jam në zyre", pastaj i shkruan kështu "T. a po vjen a jo? Sjam njeri për hajgare... trego që nuk vjen".

Po ashtu me dt.23.03.2014 ora 16:40 i akuzuari i shkruan kështu "Të lutem qoma një mesazh a po vjen a jo! Sjam budall tan ditën me nejt në zyre tu prit ty, respekt pak, të lutem, e pash në kafiq"?

- Ndersa komunikimi nga numri i të akuzuarës A. B., në numrin e të akuzuarit M. B. është me dt. 21.03.2014 ora 13:22, i shkruan kështu “te dera jemi ka 04”, dhe po me të njëjtën datë ora 16:18 minuta i shkruan edhe këtë mesazh “Nimi pak ma von, Tlajmroj unë, Mos ta nin”

Po ashtu gjykata ka vlerësuar dëshminë e nxjerrë – listingun e thirrjeve nga operatori Ipko, nga numri i telefoni që ka qenë në posedim të të akuzuarës A. B. ..., dhe numri i të akuzuarit M.B. ...

Dëshmitë e tilla konsiderohen objektive, me shkallë të lartë të besueshmërisë dhe nuk vëhet në pyetje vërtetësia e tyre.

Sms e shkëmbyera nga telefoni i M.B. në numrin e të akuzuarës A.B., qartazi pasqyrojnë gjendjen reale për raportet se e akuzuara A.B. ia mundësonte komunikimin të dëmtuarës përmes telefonit të saj me të akuzuarin M.B., se takimet e të dëmtuarës me të akuzuarin po bëheshin gjatë orarit të punës por edhe pas orarit të punës në zyren e tij. Se i akuzuari M. B. përmes sms-ve i referohej personit me nofken T., se ai kërkonte nga T. që të vinte në zyre se do t’ia ipte ai 20 euro.

5. Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarve dhe vlerësimi i tezës së mbrojtësve të tyre.

Mbrojtja e të akuzuarës A. B. në fazën e shqyrtimit gjyqësor është përqendruar në atë se me M. është shoqëruar pa pasur kurrfare interesi me të, se veprimet e saj i konsideron si të shoqes më të mirë që kishte M., se nuk i kishte bërë asnjë të keqe asaj.

Mbrojtja e saj është në tërësi e paqëndrueshme dhe nuk gjen mbështetje me asnjë provë tjetër, mbrojtja e saj në tërësi demantohet nga dëshmia e të dëmtuarës M.M., e cila ka deklaruar se fillimisht kam menduar se A. me do si motrën por pastaj kam kuptuar se ajo më konsideron si prostitute, pastaj mbrojtja e saj bie në kundërshtim edhe me pohimet e dëshmitarit P. E. se ishte e akuzuara ajo që nga ai kërkoi 30 euro për t’ia bërë M. dhe nga transkriptet e përgjimeve të telekomunikimeve, ku shihet qaratazi se telefoni i të akuzuarës në vazhdimësi ka shërbyer mjet komunikimi i të dëmtuarës M. për t’u takuar jo vetëm me të akuzuarin M. B. por edhe me persona të tjerë, edhe nga dëshmia e dëshmitarit G. K. që ka dhënë në Prokurori ka deklaruar se në disa situata kur M. përfitonte para nga ndonjë mashkull, i është lutur G. që mos t’i tregoj A., që jep të kuptohet se M. ka pasur një lloj obligimi ti sqarohet për paratë e fituara A.

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarës A.B., av.A. R., të paraqitur në fjalën përfundimtare, i cili ka kërkuar lirim nga akuza duke pretenduar se me asnjë provë nuk janë vërtetuar pretendimet e akuzës, duke potencuar dëshminë e të dëmtuarës M. M. si të vetmen provë që disponon akuza, e për dëshminë saj ka cekur se është kontradiktore dhe paraqitet si mbrojtje e të dëmtuarës për sjelljet e saj devijante për t’ia hedhur fajin dikujt tjetër në këtë rast A. B., dëshmia e saj nuk ka paraqitur asnjë rrethanë se cilat janë veprimet inkriminuese të të akuzuarës, i vetmi faj i të akuzuarës është se është shoqëruar me M., më tutje mbrojtjen ndaj të akuzuarës e shtjellon duke mohuar kryejn e veprës penale – trafikim me njerëz siq është akuzuar fillimisht e akuzuara, me theks të veçantë ka cekur se e akuzuara as nuk e ka rekrutuar të dëmtuarën e as nuk ka përfituar asgjë nga e dëmtuara. Se e dëmtuara ka qenë e lirë në përzgjedhjen e saj me meshkuj, nuk e ka shtyer askush, këtë sipas mbrojtjes e vërteton dëshmitari G. K. i cili ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me të dëmtuarën, poashtu mbrojtja ka cekur se e akuzuara nuk e ka njohur të

akuzuarin M. B., e as nuk ka ndërmjetësuar për shoqërim me M. Ndërsa për adresën në facebook në emër të T.M. ka deklaruar se atë adresë e ka hapur G. K., kjo është vërtetuar sipas dëshmisë së dëshmitarit D. G., ka kërkuar që të merren parasysh edhe dëshmitarët T. N., P. E., e M. K.

Por gjykata vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të të akuzurës avokati A. R. janë të paqëndrueshme nga arsyetimi që do të jepet si në vijim:

Se nuk është kontestuese se e akuzuara A. B. ka pasur nën kontrollën e saj të plotë të dëmtuarën M., një pjesë të kohës arrinte ta kontrollonte përmes G., ndërsa një pjesë të madhe të kohës ishin së bashku, porse e akuzuara edhe e ndihmoi të dëmtuarën, duke ia lehtësuar punën e kontaktimit me meshkuj dhe caktimit të takimeve e madje edhe qmimin e përcaktonte vet e akuzuara, se sa para do të pranonte e dëmtuara nga personi që do të takohej me të e, sipas deklaramit bindës të të dëmtuarës ajo nuk e përcaktonte shumën e të hollave që merrte nga personat që takohej me ta e as nga ata që u ofronte shërbime seksuale, sepse sipas saj ata e dinin se sa para duhet të më jepnin, pasi që për një gjë të tillë ishin marr vesh me të akuzuarën përmes kontaktimit në facebook-it nga adresa T. M.

Edhe pse i akuzuari M. B. ka shfrytëzuar të drejtën ligjore të mbrojtjes në heshtje, në fjalën përfundimtare ka thyer heshjten duke u deklaruar në mbrojtjen e tij se merret me aktivitet humanitare, se për veprimatrinë e tij humanitare e dijnë i tërë qyteti i Prizrenit. Verpimtarinë e tij humanitare e ka organizuar përmes deputeteve të Kuvendit të Kosovës dhe me Ministrinë e Shëndetësisë të RK-së, që personave me sëmundje të rënda siq janë diabeti, kanceri, sëmundje të zemrës, ashtu që përmes Ambasadës së RK-së në Ankara ka arritur t'iu ofroj 24 personave shërim në spitalet e Turqisë. Kështu që në ndërlidhje me këtë i ka arsyetuar edhe veprimet e tija në raport me M. M., duke shtuar se ajo i është ofruar duke i kërkuar ndihmë kinse ka nënën të sëmurë, ka pohuar se e ka pranuar në zyre 3-4 herë, ajo i është prezentuar si T. M. dhe çdo herë ka ardhur me një person G.K. që e ka prezentuar si vëllain e saj, për ndihmën e dhënë asaj dhe familjes M. e kanë ditur edhe familja gjegjësisht bashkëshortja. Implikimi i tij në kryerjen e veprës penale i ka ndikuar në përkeqësimin e gjendjes shëndetësore, si dhe në përkeqësimin e raporteve familjare.

- Mbrojtja e tillë e të akuzuarit M. B. duke i justifikuar veprimet e tija me aktivitete humanitare shihet qartazi që ishte e konstruktuar në atë mënyrë që ti shmanget përgjegjësisë penale juridike.

Ndërsa mbrojtësi i të akuzuarit M. B. **av.B.T.** versionin e mbrojtjes ndaj të akuzuarit e ka paraqitur duke përshkruar në mënyrë precize tërë epilogun procedural të kësaj çështjeje penale, në të gjitha stadet e zhvillimit, në veçanti ka analizuar dëshmitë e të gjithë dëshmitarve dhe provave materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor, dhe ka nxjerrë këto konkludime se:

Se i akuzuari M. B. është person në moshë, i cili ka autoritet në mesin ku jeton, i njëjti ka qenë në detyrë të D. të F. në K. e Prizrenit, në mënyrë aktive është marrë me aktivitete humanitare. Ndërsa dëshminë e të dëmtuarës M. M. e ka quajtur të trilluar dhe të konstruktuar nga persona të caktuar me qëllim të njollosjes së imazhit të të akuzuarit M. B. Po ashtu av. B. T., të dëmtuarën e ka cilësuar një person me karakter labil, me një të kaluar jo të pastër, ndërsa ka theksuar se për nga pamja e dëmtuara len përshtypje të një vajze të rritur të moshes 20 vjeçare, andaj duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana ka propozuar që dëshmisë së saj të mos i falet besim. Në shtjellim të mëtuajtshëm të mbrojtjes av. B. T., ka theksuar se duke pasur parasysh dispozitat e nenit 147 paragraf 2 të KDM-së, ku decidivisht është cekur se kur fëmija është i dëmtuar në një çështje

penale, ai nuk mund të merret në pyetje më shumë se dy herë, andaj në rastin konkret e dëmtuara është marrë në pyetje më shumë se dy herë, pra ky veprim procedural e bënë edhe më të pavlefshëm dëshminë e të dëmtuarës dhe gjykata sipas nenin 261 paragraf 1 të KPP-së, nuk mund ta bazoj aktgjykimin e saj vetëm në një dëshmi, duke pasur parasysh se vetëm dëshmia e të dëmtuarës e inkriminon të akuzuarin M. B., dhe bazuar në tërë këto të dhëna ka propozuar që gjykata ta liroj të akuzuarin M. B. nga akuza.

Mbrojtja e paraqitur nga mbrojtësi av. B. T. është pjesërisht e bazuar, duke pasur parasysh të cekurat e mbrojtësit, lidhur me dëshminë e të dëmtuarës dhe validitetin e kësaj dëshmie gjykata sqaron se është e vërtetë se nga e dëmtuara është marrë dëshmia e saj më tepër se dy herë, por në rastin konkret duhet pasur parasysh këto rrethana:

Se e dëmtuara në kohën e zhvillimit të procedurës gjyqësore ka qenë mbi moshën 16 vjeçare, dhe se trupi gjykues ka vlerësuar se marrja e sërishme në pyetje e të dëmtuarës është tejet nevojshme për të sqaruar rrethanat vetëm sa i përket të akuzuarit të dytë M. B. pasi që kur është zhvilluar seanca mbi mundësinë hetuese të veçantë ndaj të akuzuarit M. B. atë kohë ende nuk ishin hapur hetimet ndaj tij vetëm pas dhënies së dëshmisë se të dëmtuarës në atë seancë ka rezultuar me aktvendim mbi zgjerimin e hetimeve edhe ndaj të akuzuarit M. B., andaj i akuzuari në asnjë fazë të procedurës penale nuk kishte pasur rast të ballafaqohet me dëshminë e të dëmtuarës e as të parshtrij pyetje të njejtës, duke u gjendur përpara këtyre rrethanave gjykata ka vepruar konform nenit 339 të KPP-së ku në menyrë decidive është cekur se në shqyrtimin gjyqësor nuk lejohet marrja në pyetje e personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjeç që është viktimë e veprës penale nga Kapitulli XX i Kodit Penal, nëse dëshmia e tij veç është marrë sipas nenit 132 ose nenit 149 të këtij Kodi dhe nëse trupi gjykues çmon se marrja e sërishme në pyetje nuk është e nevojshme, pra kjo dispozite ligjore i referohet kufizimit të dhënies së dëshmisë nga viktima që është nën moshën 16 vjet.

6. Analiza e fjalës përfundimtare të Prokurorit të Shtetit.

Është parë e nevojshme që të analizohet edhe fjala përfundimtare e Prokurorit të Shtetit, i cili konsideron se në bazë të provave dhe dëshmimeve të paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarës A. B. janë formuar elementet e veprës penale – mundësim i prostitucionit, nga neni 241 paragraf 4 të KP-së dhe në veprimet e të akuzuarit janë formuar elementet e veprës penale – sulm seksual, nga neni 232 paragraf 1 i KP-së.

Rrjedhimisht sa i përket të akuzuarës A. B. dhe veprimeve të saj në drejtim të kryerjes së veprës penale gjykata vlerëson se rikualifikimi ligjor i bërë nga Prokurori i Shtetit i përgjigjet në tërësi veprimeve të të akuzuarës A. B. dhe elementeve qenësore të veprës penale – mundësim i prostitucionit, nga neni 241 paragraf 4 i KP-së, nga se paragrafi 4 i këtij neni përfshin kategorinë e posaçme të personave ndërmjet moshës 16 dhe 18 vjet.

Gjykata ka analizuar fjalën përfundimtare të Prokurorit të Shtetit edhe në pjesën që ka të bëjë me të akuzuarin M. B. dhe ka gjetur se edhe pas ricilësimit juridik të bërë nga Prokurori i Shtetit, veprimet e të akuzuarit nuk përbëjnë figurën e veprës penale – sulm seksual, nga neni 232 paragraf 1 i KP-së, kjo për faktin se për të ekzistuar kjo vepër penale medoemos kërkohet që viktima të mos ketë dhënë pëlqim për prekje. Shprehja "pëlqim" nënkupton pajtim i vullnetshëm i personit që ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë vjet për të kryer aktin seksual, ndërsa nuk ekziston pëlqimi nese:

Përsoni i tillë me fjalë ose me sjellje shpreh mungesë për të kryer aktin seksual ose për ta vazhduar atë.

Pajtimi është shprehur me fjalë ose me sjelljen e një personi tjetër dhe jo të viktimës.

Pajtimi i viktimës është marrë me mashtrim, frikësim ose me kërcënim, nëse mënyra e tillë nuk përfshin përdorimin e forcës, kanosjes serioze ose shfrytëzim.

Përsoni i tillë është i paaftë për të dhënë pajtimin për aktivitet seksual për shkak të aftësisë së zvogëluar mendore ose fizike ose dehjes me alkool, drogë ose me substanca tjera.

Kjo është vepër e prëbërë dhe përbëhet nga detyrimi dhe prekja e personit tjetër me qëllim seksual.

Në kontekst të kësaj gjykata gjen se e dëmtuara M. M. në kohën kur kishte krijuar kontaktet fizike me të akuzuarin M. B. ka qenë mbi 16 vjeçare, sipas deklarimit të të dëmtuarës i akuzuari e kishte prekur të njëjtën në pjesë të ndryshme të trupit duke përfshirë edhe pjesët intime të trupit të saj, gjithnjë sipas deklarimit të të dëmtuarës ajo nuk kishte dashur që ai ta prekte, prekja nga i akuzuari ishte bërë në zyrën e të akuzuarit, këto prekje i akuzuari i kishte përsëritur çdo here që kishte shkuar e dëmtuara, pas çdo prekje i akuzuari i kishte dhënë asaj para në vlera prej 10-20 euro edhe here pas here dhe ndonjë mbushje telefonike.

Andaj përfundimisht vihet në konkludim se e dëmtuara heshtazi kishte dhënë pëlqimin që i akuzuari M. B. t'a prekte të njëjtën, për faktin se po të mos ekzistonte pëlqimi i të dëmtuarës pas herës së parë që e kishte prekur i akuzuari M. B. ajo nuk do të shkonte më në zyrën e tij, por e dëmtuara e shtytur edhe nga e akuzuara A. nuk u ndalë por vazhdoi të shkonte ta vizitonte të akuzuarin M. B. madje edhe shumë herë të tjera, se ajo nga këto prekje që po ia bënte i akuzuari po përfitonte para, edhe pse e njëjta ka thënë se kur i akuzuari ka filluar ta prekë ajo ka refuzuar, që për bindjen e gjykatës kjo pjesë e deklaratës mbetet në suaza të dyshimit sepse po të ekzistonte refuzimi në ndonjë mënyrë i të dëmtuarës, ajo mund ti shmangej qfarëdo kontakti me të akuzuarin, sepse siq e cekëm edhe më lartë takimet në mes të akuzuarit M. B. dhe të dëmtuarës po ndodhnin në zyrën e të akuzuarit dhe gjatë orarit të punës, andaj qfarëdo klithme po të ketë lëshuar e dëmtuara si shenjë refuzimi ndaj të akuzuarit ajo klithmë e saj do të mund të dëgjohej nga ndonjë person që në atë kohë gjendeshin në orarin e punës, apo nëse e dëmtuara do të qante apo do të dilte nga zyra e të akuzuarit M. B. duke qarë në ndërlidhje logjike konstatohet se do të ishte e pamundur të mos vërehej nga ndonjë punëtor të cilët punonin në atë drejtori apo në dalje të objektit ku gjithnjë qëndron një punëtor sigurimi.

7. Të gjeturat e Gjykatës

Sa i përket pjesës dënuese të këtij aktgjykimi gjykata gjenë se pas vlerësimit të gjithëanshëm të të gjithave provave pa dyshim është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarës A. B., ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale – mundësim i prostitucionit, nga neni 241 paragraf 4 i KP-së.

Se me veprimet e të akuzuarës janë realizuar të gjitha elementet e veprës penale – mundësim i prostitucionit, nga neni 241 paragraf 4 i KP-së, vërtetohet me faktin se e akuzuara A. B., gjegjësisht veprimet e saj në kryerjen e kesaj vepre janë paraparë në mënyrë alternative dhe përfshinë forma të ndryshme në ushtrimin e prostitucionit siq janë: rekruton që do thotë gjetja e

personave të prostitucionit duke i joshur për dobitë nga kjo veprimtari, e përforcon bindjen e përsëritur të cili ka dilema për ushtrimin e prostitucionit.

Ndihmon në gjetjen e klientëve për të shfrytëzuar shërbimet seksuale, pasatj dhe elementi tjetër ai i kontrollit psh. kontrollimi i shfrytëzuesit për pagesë.

Por gjithësesi është e padiskutueshme se përkrahimi i lartcekur i dispozitës ligjore inkriminon në formë alternative veprimet të cilat i ka kryer e akuzuara A. B., dhe atë hapja e email adresës në facebook në emrin e T. M., që e përshkruan të dëmtuarën si një vajzë që ofron shërbime seksuale me pagesë, e cila përmes kësaj adrese arrin të kontaktoj me persona të ndryshëm. Pastaj dhënia në dispozicion të telefonit të saj celular për të venë kontakt me personat me të cilët do të takohet e dëmtuara. Kontrolli përmament ndaj të dëmtuarës që është arritur përmes tezakut të saj G. por edhe drejtëpërdrejtë nga e akuzuara, dhe në fund përfitimi pasuror që ka përfituar nga kjo veprimtari.

8. Vlerësimi lidhur me denimin e shqiptuar,

Me rastin e marrjes së vendimit mbi denimin gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 74 të KP-së, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se e akuzuar është e pagjykuar më parë, nga rrethanat rënduese janë vlerësuar: moshja e viktimës, dhe pozita e saj ndjeshme (e dëmtuara në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë mbi moshën 16 vjeqare), motivi i të akuzuarës që është motiv të natyrës fitimprurëse, e posaqërishtë keqpërdorimi i pozitës së saj dhe shkelja e besimit, nga se e akuzuara dhe e dëmtuara fillimisht ishin shoqe të mira dhe njiheshin familjarisht.

Andaj gjykata ka formuar bindjen se me shqiptimin e këtij denimi do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i denimit dhe njëkohësisht do të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale, veqanarisht të këtij lloji.

9. Kërkesa pasurore juridike dhe shpenzimet procedurale

Konform nenit 463 paragraf 2 të KPP-së, gjykata ka udhëzuar të dëmtuarën M. M., që kërkesën pasurore juridike mund ta realizon në kontest civil, meqë gjatë zhvillimit të procedurës penale nuk janë paraqitur të dhëna të plota e as të pjesërishtme për të vendosur lidhur me kërkesën e tillë.

Gjykata duke vepruar konform nenit 450 dhe 453 të KPP-së, obligoi të akuzuaren që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 eurove, e cila shumë është caktuar duke pasur parasysh ndërlikueshmerin e çështjes, kohëzgjatjen e procedurës si dhe gjendjen financiare të të akuzuarës.

II.

Sa i përket pjesës së dytë, përkatësisht pjesës liruese të këtij aktgjykimi, Gjykata ka bërë administrimin e provave dhe ka dëgjuar dëshmitarë të përshkruar hollësisht në pjesën e parë të këtij aktgjykimi.

Nga këto prova është vërtetuar relacioni në mes të akuzuarit M. B. dhe të dëmtuarës që ka ekzistuar në periudhën kohore mars – maj 2014, e në atë periudhë e dëmtuara e mitur M. M. ka qenë mbi moshën 16 vjeqare, andaj veprimet e të akuzuarit M. B. sipas bindjes së gjykatës vlerësohen si veprime të pahijshme, jo etike e që bien ndesh me normat e moralit shoqëror por që nuk përbëjnë figurën e veprës penale – sulm seksual, nga neni 232 paragraf 1 i KP-së.

Andaj nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPP-së, *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. E në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë “*in peius*” ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (*beyond reasonable doubt*) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë “*in favorem*” ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Andaj në rastin konkret trupi gjykues e liroi të akuzuarin nga kjo pikë e akuzës nga se veprimet e tij nuk përbëjnë veprën penale të pretenduar sipas aktakuzës së prokurorisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale për këtë pjesë të procedurës është marrë konform nenit 454 paragraf 1 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për të Mitur
P.nr.190/2014 të dt.21.01.2016

Sekretare juridike,
Besnike Morina

Kryetare e trupit gjykues
Kymete Kicaj

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmjet kësaj gjykate.